



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 31 gusht

Njoftim për shtyp

Zhvillimet më të rëndësishme në normat e interesit të bankave dhe shtëpive të kursimit¹: korrik, 2021

- Në muajin korrik 2021, norma mesatare e interesit të totalit të kredive shënoi ulje mujore dhe vjetore prej përkatësisht 0,04 p.p. dhe 0,25 p.p. duke arritur në 4,50%. Norma mesatare e interesit të totalit të depozitave arriti në 0,83% dhe shënoi rënie mujore prej 0,01 p.p dhe rënie vjetore prej 0,22 p.p.
- Norma mesatare e kredive të reja² arriti 3,62% dhe shënoi ulje mujore dhe vjetore prej përkatësisht 0,41 p.p. dhe 0,36 p.p. Norma mesatare e interesit të depozitave të reja është 0,51% dhe shënoi ulje mujore dhe vjetore prej 0,02 p.p. dhe 0,18 p.p.

Tabela 1. Normat e interesit të totalit të kredive dhe depozitave të reja^{3,4,5}

	7.2020	9.2020	12.2020	1.2021	2.2021	3.2021	4.2021	5.2021	6.2021	7.2021
во % на годишно ниво										
Вкупни кредити	4.75	4.70	4.63	4.62	4.61	4.59	4.58	4.56	4.54	4.50
Корпоративен сектор	3.89	3.80	3.73	3.71	3.70	3.70	3.70	3.68	3.65	3.61
Домаќинства	5.56	5.53	5.46	5.45	5.43	5.40	5.37	5.35	5.33	5.30
Новоодобreni кредити	3.98	3.99	3.78	3.98	4.25	3.94	4.09	3.84	4.03	3.62
Корпоративен сектор	3.64	3.82	3.42	3.60	3.76	3.51	3.85	3.31	3.43	3.04
Домаќинства	4.48	4.51	4.38	4.56	4.68	4.61	4.49	4.61	4.64	4.58
Вкупни депозити	1.05	0.98	0.95	0.93	0.92	0.89	0.90	0.85	0.84	0.83
Корпоративен сектор	1.29	1.14	1.22	1.22	1.20	1.15	1.19	1.16	1.16	1.11
Домаќинства	1.03	0.96	0.92	0.89	0.88	0.86	0.87	0.82	0.80	0.79
Новопримени депозити	0.69	0.76	0.68	0.62	0.71	0.76	0.62	0.67	0.53	0.51
Корпоративен сектор	0.57	0.74	0.38	0.40	0.39	0.75	0.65	0.74	0.51	0.42
Домаќинства	0.79	0.78	0.85	0.66	0.86	0.77	0.61	0.64	0.53	0.57

Burimi: BPRMV.

¹ Normë „interesi“ do të thotë një normë mesatare e ponderuar e interesit e shprehur në përqindje në bazë vjetore. Për shpjegim më të hollësishëm, shih Metodologjinë:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjija/Metodologjija_MIR_07_2018_mak.pdf

² Zhvillime të ndryshueshme janë karakteristike sa u përket normave të interesit të kredive/depozitave të reja. Zhvillimet e këtylla të normave të interesit janë si rezultat i ndryshimeve në vëllimin e depozitave/kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshojnë konsiderueshëm), si dhe nga norma e rënë dakord e interesit.

³ Efektet nga ndryshimet në metodologjinë të publikuara në informacionin e 20 korrikut të vitit 2018 (www.nbrm.mk/content/statistika/informacii/Informacija_za_promeni_vo_monetarnata_statistika_mk.pdf) nuk vërehen në kategoritë individuale të normave të interesit të depozitave/kredive (në denarë pa klauzolë valutore, në denarë me klauzolë valutore dhe në valutë të huaj), por vetëm në normat agregate të interesit (në denarë dhe valutë të huaj) të cilat nuk janë subjekt i analizës në njoftim, por publikohen në internet faqen e BPRMV-së.

⁴ Në gusht të vitit 2020 revokohet leja për themelim dhe punë e një banke. Të dhënat për normat e interesit për korrik të vitit 2020 i përfshinë të dhënat e qershorit për normat e interesit për këtë bankë.


⁵ Të dhënat për normat e interesit të muajit gusht të vitit 2020, nuk i përfshijnë të dhënat për një bankë të cilës në gusht të vitit 2020 i është revokuar leja për themelim dhe punë dhe për të cilën është iniciuar procedurë falimentimi.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

1. Normat e interesit të sektorit të korporatave⁶


- Në muajin korrik norma e interesit të totalit të kredive të miratura në sektorin e korporatave është 3,61% dhe është zvogëluar për 0,04 p.p. krahasuar me muajin e kaluar. Rënia është pasojë e uljes së normës së interesit të kredive në denarë pa dhe me klauzolë valutore për 0,06 p.p., ndërsa normat e interesit të kredive në valutë të huaj mbeten të pandryshuara. Analizuar në bazë vjetore, norma e interesit të totalit të kredive të miratuara në sektorin e korporatave u zvogëlua për 0,28 p.p.




Burimi: BPRMV.



- Në muajin korrik, norma e interesit e kredive të reja të sektorit të korporatave është 3,04% dhe shënoi rënie mujore prej 0,39 p.p. Rënia është pasojë e uljes në të gjithë komponentët e kësaj norme të interesit: uljes së normës së interesit të kredive në denarë pa dhe me klauzolë valutore (për përkatësisht 1,00 p.p. dhe 0,01 p.p.) dhe normës së interesit të kredive në valutë të huaj (për 0,06 p.p.). Krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar kjo normë ka shënuar ulje prej 0,60 p.p.



Burimi: BPRMV.




⁶ Për nevojat e këtij njoftimi, sektori i korporatave i përfshin institucionet jofinanciare (publike dhe të tjera).




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Këtë muaj, norma e interesit e totalit të depozitave të sektorit të korporatave është më e ulët për 0,05 p.p. në bazë mujore dhe shënon 1,11%. Ulja është rezultat i rënies së normave të interesit të depozitave në valutë të huaj dhe normës së interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore (për përkatësisht 0,06 p.p dhe 0,05 p.p.) në kushte ku norma e interesit e depozitave në denarë me klauzolë valutore ngelet e pandryshuar. Në bazë vjetore kjo normë e interesit është zvogëluar për 0,18 p.p.
- Në korrik norma e interesit e kredive të reja⁷ të sektorit të korporatave është 0,42% dhe shënoi rënie prej 0,09 p.p. Rënia në tërësi është rezultat i uljes së normës së interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,62 p.p.), gjatë rritjes së shënuar të normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore (për 0,07 p.p.). Këtë muaj bankat dhe shtëpitë e kursimit nuk kanë pranuar depozita në denarë me klauzolë valutore. Në bazë vjetore norma e interesit e kredive të reja të depozitave të sektorit të korporatave është më e ulët për 0,15 p.p.

2. Normat e interesit e kredive për amvisëri⁸



Burimi: BPRMV.



- Norma e interesit të totalit të kredive për amvisëri në korrik është zvogëluar për 0,03 p.p. krahasuar me muajin e kaluar dhe është 5,30%. Rënia është rezultat i uljes së normës së interesit të kredive në denar pa dhe me klauzolë valutore (për 0,07 p.p. dhe 0,02 p.p.), në kushte të rritjes së normave të interesit të kredive në valutë të huaj (për 0,21 p.p.). Krahasuar me muajin korrik të vitit të kaluar, norma e interesit të totalit të kredive për amvisëri shënoi ulje prej 0,26 p.p.



⁷ Në grafikun që u referohet normave të interesit të depozitave të reja të sektorit të korporatave, ndërprerja në serinë e të dhënave për normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është për shkak të faktit se në muaj të caktuar bankat dhe shtëpitë e kursimit nuk kanë marrë depozita të tilla nga sektori i korporatave.

⁸ Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë përfshinë: persona fizikë, persona të vetëpunësuar dhe institucioni jofitimprurëse të cilat u shërbejnë amvisërive



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Këtë muaj, norma mesatare e kredive të reja të amvisërive është 4,58% dhe shënoi ulje në bazë mujore prej 0,06 p.p. Rënia është rezultat i uljes së normave të interesit të kredive në valutë të huaj dhe kredive në denarë me klauzolë valutore (prej përkatësisht 0,13 p.p. dhe 0,08 p.p.), gjatë rritjes së realizuar të normave të interesit të kredive në denarë pa klauzolë valutore (për 0,09 p.p.). Analizuar në bazë vjetore, kjo normë interesi shënoi rritje prej 0,10 p.p.



Burimi: BPRMV.

- Në muajin korrik norma e interesit e totalit të depozitave të amvisërive në bazë mujore u zvogëluar për 0,01 p.p. dhe është 0,79%, si pasojë e zvogëlimit të normës së interesit të depozitave në denarë pa dhe me klauzolë valutore (për përkatësisht 0,04 p.p. dhe 0,01 p.p.), në kushte kur normat e interesit të depozitave në valutë të huaj shënojnë rritje (për 0,02 p.p.). Norma e interesit e totalit të depozitave të amvisërive në bazë vjetore është më e ulët për 0,24 p.p.
- Këtë muaj norma e interesit e depozitave të reja të amvisërive⁹ është 0,57%, me çka paraqet rritje mujore prej 0,04 p.p. Kjo rritje është rezultat i rritjes së normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore dhe normave të interesit të depozitave në valutë të huaj (për përkatësisht 0,05 p.p. dhe 0,03 p.p.), në kushte kur nuk janë pranuar depozita në denarë me klauzolë valutore. Kjo normë e interesit është zvogëluar për 0,22 p.p., krahasur me muajin korrik të vitit të kaluar.

⁹ Në grafikun që u referohet normave të interesit të depozitave të reja të amvisërive, ndërprerja në seritë e të dhënave në normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është për shkak të faktit që në muaj të caktuar bankat dhe shtëpitë e kursimit nuk kanë pranuar depozita të amvisërive të këtij lloji.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Informacione shoqëruese

Të dhënat e serive kohore: Të dhëna vjetore, tremujore dhe mujore për normat e ponderuara të interesit të bankave dhe shtëpive të kursimit
http://www.nbrm.mk/statistika_na_kamatni_stapki.nspix

Shpjegime metodologjike:

<https://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia>

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

http://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_na_objavuvanje_podatoci.pdf

Të dhëna mujore për normat e interesit: 30 shtator 2021 (mesatare referuese duke përfshirë edhe gushtin 2021).

Për pyetje gazetarësh, ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 116 (ose 112/110/108).